

V E N D I M
Nr.79, datë 31.12.1998

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë e përbërë nga:

Hilmi Dakli,	Anëtar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci,	Anëtar i “““
Hajredin Fuga,	Anëtar i “““
Alfred Karamuço,	Anëtar i “““
Bardha Selenica,	Anëtare e “““
Kujtim Puto,	Anëtar i “““
Sokol Sadushi,	Anëtar i “““

me sekretare Noela Ruço, më datat 18.12.1998 dhe 23.12.1998 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.83 Akti që i përket :

K E R K U E S : RIDVAN RESULI, në mungesë.

SUBJEKT I INTERESUAR : DREJTORIA E SHERBIMEVE QEVERTARE, në mungesë.

O B J E K T I:

Deklarimin antikushtetues të vendimit nr.974, datë 30.6.1998 të kolegjit civil të Gjykatës së Kasacionit.

Kërkuesi parashtron si shkaqe për antikushtetutshmërinë e vendimit të kolegjit civil të Gjykatës së Kasacionit, moszbatimin nga kjo gjykatë të vendimit të Gjykatës Kushtetuese që për këtë çështje ka vendosur rishqyrtimin e saj nga kolegji civil i Gjykatës së Kasacionit.

Gjykata Kushtetuese pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

V E R E N:

Kolegji civil i Gjykatës së Kasacionit me vendimin nr.974, datë 30.6.1998 me palë Ridvan Resuli dhe Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare, në seancë gjyqësore, ka vendosur mospranimin e çështjes për shqyrtim, duke arsyetuar se vendimet e Gjykatës së Kasacionit nuk mund të cënohen apo ndryshohen nga asnjë organ apo instancë tjetër, dhe Gjykata Kushtetuese nuk mund të investojë asnjë gjykatë për shqyrtimin e çështjeve gjyqësore.

Ky vendim i kolegjit civil të Gjykatës së kasacionit jo vetëm që nuk mund të konsiderohet i rastësishëm në praktikën e kësaj gjykate, por ai shpreh një qëndrim të gabuar dhe antikushtetues që është përpjekur të krijojë Gjykata e Kasacionit në këtë drejtim.

Gjykata Kushtetuese në vendimet e saj nr.57 dhe 58, datë 4.11.1998 duke shpallur antikushtetues vendimet e gjykatave për çështjet konkrete që lidheshin me dy vendimet e sipërcituara, si dhe duke interpretuar nenet 24 pika 9 dhe 26 të dispozitave kushtetuese, e ka shprehur qartë qëndrimin që duhet mbajtur nga çdo organ, qoftë dhe nga organet gjyqësore për zbatimin e padiskutueshëm të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, si vendime përfundimtare dhe të formës së prerë. Asnjë organ, i çdo lloji pushteti; legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor, nuk mund të verë në diskutim zbatimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese. Çdo shkelje e vërejtur në këtë drejtim cënon rëndë parimet kushtetuese. Gjykata Kushtetuese, si autoriteti më i lartë që garanton respektimin e kushtetutës, nuk mund të lejojë qëndrime të tilla antikushtetuese nga asnjë organ.

Në këto kushte vendimi nr.974, datë 30.6.1998 i kolegjit civil të Gjykatës së Kasacionit është antikushtetues dhe në bazë të nenit 45 të Ligjit nr.8373, datë 15.7.1998 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë“ nuk sjell asnjë efekt juridik.

Vendimi nr.54, datë 21.11.1997 i Gjykatës Kushtetuese i cili ka vendosur shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr.186, datë 13.2.1996 të kolegjit civil të Gjykatës së Kasacionit dhe rishqyrtimi i saj nga ajo Gjykatë mbetet i detyrueshëm për t’u zbatuar nga Gjykata e Kasacionit.

PER KETO ARSYE ;

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 131 të Kushtetutës, njëzëri,

V E N D O S I :

Shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr.974, datë 30.6.1998 të kolegjit civil të Gjykatës së Kasacionit.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më 31.12.1998

Nr. 83 i regjistrimit themeltar

Nr. 79 i vendimit